

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E STANDARDIZIMIT

Puna e kësaj drejtorie ka konsistuar në zbatimin e detyrave që dalin nga Plani Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit (PKZMSA) i cili ka reflektuar detyrimet e DPS ndaj nenit 75 të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit.

Bazuar në sa më sipër prioritetet tona në terma afatshkurtër dhe afatgjatë respektivisht janë:

- ✚ Marrja e masave për të rritur ndërgjegjësimin e operatorëve ekonomikë në lidhje me konceptet e standardeve dhe çertifikimit dhe rëndësisë së tyre në tregtinë ndërkombëtare;
- ✚ Sigurimi i kapaciteteve administrative për të zbatuar MSA;
- ✚ Progres i mëtjshëm në adoptimin e standardeve europiane dhe rritje e përpjekjeve për t'u bërë anëtar me të drejta të plota në CEN&CENELEC;
- ✚ Përmirësimi i funksionimit të DPS si Organi Kombëtar i Standardeve, duke aplikuar praktikat më të mira europiane.

Ç'farë është realizuar gjatë këtij viti:

Nisur nga sa parashikohet në PKZMSA, kërkesat në rritje të ekonomisë vendase dhe nga prioritetet në fushën e standardizimit është bërë një rishikim i plotë i ligjit ekzistues “Për Standardizimin”, i cili çoi në konkluzionin se ky ligj është i papërshtatshëm për të përmbushur këto detyrime, është i papërshtatshëm për t'ju përgjigjur kërkesave të kohës dhe është një ligj që nuk ka përafuar të plotë rekomandimet e BE-së në zbatim të legjislacionit, standardeve dhe praktikave europiane e ndërkombëtare në fuqi për fushën e standardizimit. Kështu, gjatë vitit është punuar për hartimin e një projekt ligji të ri për Standardizimin, i cili në Dhjetor 2007 është miratuar nga Këshilli i Ministrave.

Për draftimin e këtij projekt ligji DPS është mbështetur në përcaktimet e dhëna në dokumenta europiane e ndërkombëtare si vijon:

Rekomandimet e dhëna në botimin e KE-së, rishikuar në 2005 “Strukturat kryesore administrative të nevojshme për implementimin e *acquis* – pika 1 – **Lëvizja e Lirë e mallrave - Masat Horizontale**, germa a) **Standardizimi**;

Direktivën 98/34/EC datë 22.06.1998 „**Shkëmbimi i informacionit në fushën e standardeve dhe rregullave teknike**“;

Ligjin nr. 8648, datë 28.7.2000 për ratifikimin e “Protokollit të antarësimit të Republikës së Shqipërisë në “Marrëveshjen e Marrakeshit, që themeloi Organizatën Botërore të Tregtisë” - **Marrëveshja e Barrierave Teknike në Tregti** Aneksi III “**Kodi i praktikës së mirë për përgatitjen, adoptimin dhe zbatimin e standardeve**”;

Rregulloren e brendëshme Nr.2 të Komiteve Europiane të Standardizimit

CEN & CENELEC „Rregulla të përbashkëta për punën e standardizimit“;

Rregulloren e brendëshme Nr.3 të Komiteteve Europiane të Standardizimit CEN & CENELEC „Rregulla për strukturën dhe draftimin e publikimeve/standardeve të CEN&CENELEC“;

Udhëzuesi 10 i CEN & CENELEC „Udhëzime për shpërndarjen dhe shitjen e publikimeve/standardeve të CEN&CENELEC“;

Standardin Shqiptar që ka adoptuar atë ndërkombëtar S SH ISO 17011;

Standardin Shqiptar që ka adoptuar atë ndërkombëtar S SH EN 45020.

Me miratimin nga Parlamenti Shqiptar të këtij drafti gjatë 6 mujorit të parë të 2008, DPS realizon fazën tjetër të parashikimit në PKZMSA që në Qershor 2008 ky ligj të hyjë në fuqi. Me miratimin e këtij ligji krijohen hapsirat e nevojshme ligjore për ngritjen dhe funksionimin efektiv të sistemit kombëtar të standardizimit në përputhje me praktikën europiane në këtë fushë dhe arrihet progresi i kërkuar i përafritimit të legjislacionit tonë me atë të BE-së si dhe krijohet mjedisi i përshtatshëm për përmbushjen e detyrimeve në kuadër të MSA.

U bë analiza e Progres Raportit të BE-së për fushën e Standardizimit, ku megjithë arritjet e përmendura në raport kishte edhe rekomandime e këshilla të cilat do të jenë prioritet i punës sonë gjatë 2008 e në vazhdim.

Adoptimi i standardeve Europiane.

Në zbatim të PKZMSA deri në fund të vitit 2007 DPS kishte planifikuar të adoptojë si standarde shqiptare 70% të totalit të standardeve EN të të dy organizmave evropiane të standardizimit, CEN dhe CENELEC, ndërkohë që janë adoptuar 78% të tyre, ku nga standardet e CEN janë adoptuar 10340 standarde ose 89.9% e tyre dhe standarde të CENELEC janë adoptuar 2540 ose 50.7% e tyre

Gjatë vitit 2007 janë ratifikuar 3700 standarde gjithsej, nga të cilat:


2880 standarde evropiane, EN

228 standarde ndërkombëtare, ISO dhe ISO/IEC

592 amendamente, Specifikime dhe Raporte Teknike të CEN, etj

3700 standarde gjithsej

Grafiku i mëposhtëm paraqet gjendjen aktuale të Standardeve Shqiptare dhe strukturën sipas llojeve:




Standarde	S SH EN	S SH	S SH ISO	Të tjera	Totali
Numri	12880	3359	1319	753	18311

Raporti i standardeve të miratuara çdo vit pëson ndryshim, në drejtim të rritjes së numrit të standardeve ndërkombëtare dhe evropiane të adoptuara si standarde shqiptare.


Struktura e standardeve S SH ka një përmirësim të dukshëm. Tashmë standardet e pastra shqiptare zënë vetëm 18 % (nga 23% në 2006 apo 28% në 2005) të nr. të përgjithshëm të standardeve dhe vetëm standardet e adoptuara EN (duke përfshirë këtu dhe EN ISO) zënë 71% (nga 69% në 2006 apo 63% në 2005) të gjithë standardeve shqiptare.

Zhvillimi i procesit të adoptimit të standardeve të huaja kundrejt standardeve të pastra shqiptare, S SH, është bërë duke i dhënë prioritet adoptimit të standardeve Evropiane dhe ndërkombëtare. Raporti i standardeve evropiane të adoptuara si S SH ndaj standardeve të pastra shqiptare, çdo vit rritet në favor të standardeve evropiane dhe ndërkombëtare, si paraqitet dhe në grafikun krahasues të mëposhtëm:



Viti	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007
S SH të pastra	3557	3558	3558	3563	3565	3520	3487	3359
Adoptime	1281	2408	3479	5002	6525	9060	11854	14952


Progresi i standardeve shqiptare nga viti 1995 deri 2007, ka ecur si paraqitet në grafikun e mëposhtëm:



Vitet	1995	1996	1997	1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007
SSH gjithsh	4721	4786	4837	3823	3966	4838	5966	7038	8565	10081	12580	15320	18311
Stand. të huaja	42	80	116	266	409	1281	2408	3479	5002	6525	9075	11860	14952

Zhvillimi i standardeve S SH të publikuara çdo vit paraqitet si më poshtë:


Vitet e fundit, është rritur ritmi i adoptimit të standardeve të huaja, në përgjithësi, si standarde shqiptare gjë që vihet re qartë në grafikët e mëposhtëm:



Vitet	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007
Stand të reja	143	872	1128	1072	1527	1516	2499	2800	3700

Ndërsa përbërja e standardeve të huaja të adoptuara si standarde shqiptare në fund të vitit 2007 paraqitet si më poshtë:


Standard	EN	ISO	IEC	CNR	UN/ECE	Të tjera
Numri	12880	1118	214	41	33	665



Ritmi i adoptimit të standardeve evropiane, nga viti në vit, ka rritje të dukshme (si shihet dhe grafikisht).

Në zbatim të PKZMSA, puna për adoptimin e standardeve Evropiane si standarde shqiptare ka qenë prioritet dhe ka bërë të rritet çdo vit dhe më shumë nr. i standardeve të adoptuara.

Gjatë dy viteve të fundit, është rritur në mënyrë të konsiderueshme ritmi i adoptimit të standardeve evropiane elektrike dhe elektronike nga CENELEC. Gjatë vitit 2007 u adoptuan 900 standarde të CENELEC si S SH.



Vitet	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007
Stand EN, gjithsej	985	1590	2425	3907	5357	7860	10000	12880
Stand EN CENELEC	-	-	-	-	90	740	1640	2540

Adoptimi i standardeve të harmonizuara

Detyrë tjetër e rëndësishme për ne, si dhe kusht për zbatimin e nenit 75 të MSA, është adoptimi 100% i standardeve të harmonizuara. Standardet e harmonizuara janë ato standarde që dalin në zbatim të Direktivave të *New Approach*. Zbatimi i këtyre standardeve nga industria siguron dy gjëra thelbësore: zbatimin e kerkesave thelbësore të direktivave dhe nivelin më të lartë të cilësisë së produkteve në mënyrë që ato të pranohen në Tregun e Përbashkët.

Gjatë këtij viti, është punuar për të evidentuar në mënyrë të veçantë listat me standardet e harmonizuar të një pjese të direktivave, duke plotësuar me të dhëna


shitesë që do të hidhen në *database*-in e standardeve, në mënyrë që t'i shërbehet më mirë klientëve dhe të interesuarve për këto standarde.

Për t'i shërbyer dhe orientuar më mirë klientët, adoptimi i standardeve me listë nuk bëhet më. Sot standardet adoptohen me përkthim të faqes së parë, ndonëse në shumë raste kërkohen që standardet të jenë të përkthyer plotësisht. Me pak fonde të dhëna nga projekti CARDS, gjatë këtij viti u përkthyen vetëm 6 standarde dhe udhëzues.

Gjendja e tanishme e standardeve të përkthyer (mbas shfuqizimit të disa standardeve të përkthyer dhe zëvendësimi i tyre me standarde të reja S SH EN apo S SH ISO), është si më poshtë:

Standarde	S SH EN	S SH ISO	S SH CNR	S SH UN/ECE	Gjithsej
Sasia	310	23	33	14	380

Ndërsa raporti sipas mënyrës së adoptimit të standardeve të huaja, deri më 31.12.2007, paraqitet si më poshtë:



Standarde	Të përkthyer	Me faqe të parë	Me listë	Të adoptuara gjithsej
Sasia	380	13829	740	14952

Një nga detyrat tona që dalin në plotësimin e 9 kushteve, është shfuqizimi i standardeve të pastra shqiptare, apo të tjera, që janë në konflikt me standardet evropiane të adoptuara si S SH. Gjatë këtij viti janë shfuqizuar 55 standarde të pastra shqiptare, të cilat konfliktojnë ose jo me standardet EN të adoptuara, si dhe 311 standarde S SH EN dhe S SH ISO, të shfuqizuara nga organizmat përkatëse

Këtë vit janë aktivizuar dhe funksionuan rregullisht 41 Komitete Teknike, dhe janë bërë 114 mbledhje të tyre, në të cilat u diskutuan dhe u miratuan gjithsej 2880 standarde. Në këtë aktivitet janë përfshirë mbi 100 specialistë me përvojë të fushave të ndryshme, të cilët vijnë nga sektori privat dhe shtetëror, institucione shkencore, administrata publike, dhomat e tregëtisë, shoqata prodhuesish dhe konsumatori, universitetet, etj., që kanë sjellë drejtëpërdrejtë mendimet e palëve të ndryshme që

përfaqësojnë, gjatë procesit të adoptimit të standardeve. Gjithashtu me qëllimin e marrjes së mendimit të të interesuarve, listat e standardeve botohen në Buletinin periodik, si dhe publikohen në *web-site* e drejtorisë.

Me qëllim përafrimin e metodave të punës sonë me ato të Organeve të Standardizimit të shteteve anëtare të BE, pranë DPS funksionon Grupi i Ekspertëve të Standardizimit, (i përbërë nga ekspertë teknikë të fushave të ndryshme). Ky organ këshillimor, jep mendimet e tij gjatë procesit të programimit të punës për adoptimin e standardeve.

Pavarësisht nga programimi i standardeve që planifikohen të adoptohen gjatë vitit, me precedentë nga ana jonë, janë trajtuar kërkesat e klientëve të ndryshëm, për nevojat e tyre për standarde të tjera që publikohen nga organizmat ndërkombëtare, ISO dhe IEC, si dhe evropiane. Në këto raste, është përdorur për adoptim procedura e përshpejtuar. Këtë këtë vit ka patur kërkesa për standarde në fushën e akreditimit dhe certifikimit, si dhe për disa metoda analizash (në fushat e ndërtimit, mjedisit, etj)

Gjatë këtij viti gjithashtu:

- U bë një riorganizim tjetër i Komiteteve Teknike, duke bërë bashkime apo riemërtime, në mënyrë që të ketë përputhje edhe me ndryshimet e bëra në CEN dhe CENELEC.
- U punua në mënyrë intensive për plotësimin e *database* të standardeve, i cili përmban të dhëna të plota për standardet. Ky *database* i shërben përmirësimit të punës sonë brenda DPS duke shpërndarë informacionin e nevojshëm sektorëve të tjerë, si atij të informacionit dhe shitjes së standardeve, si dhe njëkohësisht është shumë i vlefshëm për palët e interesuara dhe për bashkëpunëtorët e DPS. Ky *database* ndihmoi për hartimin dhe botimin e një katalogu të ri të standardeve më të plotë.
Gjithashtu, në kuadrin e një ICT-je sa më koherente, janë bërë ndryshime në aplikacionin ekzistues "*Standards Manager Database*" me synim zgjerimin e funksionaliteve të lidhura me punën me standardet, modernizimin e strukturave të kërkimit të informacionit dhe është bërë e mundur shfaqja në faqen e Internetit të informacionit mbi standardet e adoptuara dhe krijimi i katalogut në CD.
- Për përmirësimin e mëtejshëm të punës ka vazhduar puna për shtypjen dhe formatimin e standardeve të vjetra shqiptare, që nuk janë në formë elektronike, në mënyrë që dhe ato të mund të arkivohen elektronikisht. Këtë vit janë shtypur 230 standarde (ne total janë shtypur 900 standarde)
- Është bërë punë përgatitore për pjesmarrjen në mbledhjet e KT evropiane apo ndërkombëtare.

Gjatë këtij viti, me financim të organizatës ndërkombëtare të stand. ISO, dy specialistë të drejtorisë tonë kanë marrë pjesë në trajnime, si dhe me ndihmën e programit CARDS kombëtar, dy specialistë të tjerë të kësaj drejtorie dhe dy ekspertë,

bashkëpunëtorë të DPS, kanë asistuar në mbledhje të KT të CEN dhe CENELEC, për marrje eksperience.

Është bashkëpunuar me Ministrinë, sipas përkatësisë, lidhur me heqjen e statusit të “detyruar” për standardet e përmendur në VKM, të cilët bëhen pengesë për implementimin e standardeve Evropiane dhe është arritur një reduktim me 48 standarde të listës së standardeve me këtë status.

Plotësimi i 9 kushteve për t’u pranuar anëtarë me të drejta të plota në Organizmat Evropiane të Standardizimit CEN dhe CENELEC, është një detyrim që rrjedh nga neni 75 i MSA. Në këtë drejtim është punuar si më poshtë:

Kushti 1 – Firmosja e Marrëveshjes së Stabilizimit - Asocim. Shqipëria tani është në fazën Marrëveshjes së Ndërmjetme;

Kushti 2 – Legjislacioni ynë për standardizimin është në përputhje me atë të vendeve anëtare. Në ligj standardet janë dokumenta vullnetare dhe adoptohen nga DPS në mënyrë identike me standardet Evropiane pa devijime apo ndryshime. Ato luajnë të njëjtin rol në Shqipëri sikurse e luajnë edhe në Tregun e Brendshëm të BE-së. Përsa i takon implementimit, ka ende për t’u bërë, për arsye se janë bërë pengesë disa vendime dhe rregulla teknike, të miratuara nga ministri të linjës, me anën e të cilave disa standarde, të cilët mund të jenë dhe konfliktuale me standardet evropiane të CEN, bëhen të detyrueshme. Nga ana jonë po bashkëpunohet me ta që kjo pengesë të hiqet. Si rezultat janë miratuar vendime si VKM Nr 15, dt 10.01.2007; VKM Nr 147, dt 21.03.2007; VKM Nr. 40 dt 18.01.2006 , sipas të cilëve u hiqet, ose i kufizohet në kohë, statusi “ i detyrueshëm”, mbi 180 standarde dhe grupe të tjera standardesh, që VKM Nr 646, dt 12.12.2002 dhe VKM. Nr. 281 dt 8.5.2003, i kanë dhënë atë, duke zbutur kështu barrierat teknike, drejt eliminimit të plotë të tyre. Gjithashtu edhe VKM Nr 279, dt 18.04.2007, çliron nga statusi “ i detyrueshëm”, 47 standarde që kanë këtë status nga VKM Nr. 68, datë 15.02. 2001.

Kushti 3 – Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit, sipas ligjit, është Organizmi Kombëtar i Standardizimit në Shqipëri, kompetent për të gjitha fushat që mbulon CEN dhe CENELEC, me përjashtim të standardeve të fushës së Telekomunikacionit, të cilët mbulohen nga Enti Rregullator i Telekomunikacionit (ERT).

Rregullat dhe mënyra si punohet në DPS, është duke u përafuar me mënyrën e organizimit të standardizimit vullnetar, siç veprohet në CEN/CENELEC. Gjatë këtij viti u rishikuan rregulloret dhe procedurat që të jenë sa më të përputhura me ato të CEN/CENELEC.

Proçesi i hartimit, adoptimit dhe miratimit të standardeve bëhet mbi bazën e parimeve të standardizimit ndërkombëtar – transparencë, gjithëpërfshirje, konsensus – të të gjitha palëve të interesuara në këtë proçes.

Kushti 4 – Nga ana jonë, paguhet rregullisht kuota e anëtarësimit në të dy organet Evropiane, ku ne kemi statusin e anëtarit *affiliate*.

Kushti 5 – Lista e Komiteteve Teknike të DPS pasqyrë me ato të CEN dhe CENELEC, është rishikuar këtë vit. U përpiluan listat e ekspertëve, të cilët marrin

pjesë në aktivitetet e standardizimit, sipas organizatave, filialeve, që ata përfaqësojnë.

Pjesëmarrja aktive në punën e KT të CEN dhe CENELEC, ende nuk ka filluar. Puna në Komitetet tona Teknike është në përmirësim të vazhdueshëm, qoftë nga përzgjedhja e anëtarëve të KT, si dhe eksperiencia e fituar gjatë punës. Tashmë ekziston një listë e personave që mund të marrin pjesë aktive në procesin e standardizimit, por ka nevojë për eksperiencë në këtë drejtim, si dhe, kjo është kryesore, për më tepër interes nga biznesi.

Kushti 6 – Për sa i takon pjesëmarrjes formale në proceset e CEN dhe CENELEC është e nevojshme pajisja me infrastrukturë moderne teknologjie informacioni dhe komunikimi (ITC), të cilat, në sajë të programit CARDS 2001, janë siguruar dhe personeli është duke u trajnuar për përvetësim maksimal. Nevoja për shkarkim të vazhdueshëm të informacionit nga *database* i organizmave evropiane të standardizimit ka rritur shumë vëllimin e informacionit elektronik e për rrjedhojë ka sjellë nevojën e rritjes së kapacitetit të serverit. Gjatë këtij viti kapaciteti është dyfishuar dhe kjo procedurë është në vazhdim për sa kohë që sasia e informacionit do të rritet me këto ritme. Gjithashtu, në kuadrin e një ICT-je sa më koherente, janë bërë ndryshime në aplikacionin ekzistues "*Standards Manager Database*" me synim zgjerimin e funksionaliteteve të lidhura me punën me standardet, modernizimin e strukturave të kërkimit të informacionit dhe është bërë e mundur shfaqja në faqen e Internetit të informacionit mbi standardet e adoptuara dhe krijimi i katalogut në CD.

Së fundmi po shikohet dhe mundësia për rritjen e shpejtësisë së lidhjes së Internetit në mënyrë që shkarkimi ose ngarkimi i informacionit nga dhe drejt bazave të të dhënave të Organizmave Evropiane të Standardizimit, të jetë sa më afër kohës reale.

Një mision thelbësor i DPS është implementimi i EN's, që përcaktohet në Rregullat e Brendshme të CEN/CENELEC. Ky implementim është një operacion në dy faza: t'i japë standardeve EN statusin e Standardeve kombëtare shqiptare dhe shfuqizimi i ndonjë dokumenti konfliktual. Një prej elementëve që duhet marrë në konsideratë, janë të dhënat e saj në zbatimin e EN-ve që tashmë janë miratuar. Për sa i përket tërheqjes së dokumentave kombëtare konfliktuale në Shqipëri, kur nuk është bërë, për këtë shfuqizim do të hartohet nga DPS një grafik i saktë me afate të arsyeshme kohore. 80% e implemetimeve duhet të jenë bërë para pranimit të DPS si anëtare me të drejta të plota. Do të propozohet një grafik i arsyeshëm për pjesën që mbetet të implementimit dhe për shfuqizimin e dokumentave konfliktuale që mbeten.

Kushti 7 – Një mision tjetër i rëndësishëm është implementimi i standardeve evropiane si standarde kombëtare. Faza e parë, që është adoptimi i këtyre standardeve si standarde shqiptare po realizohet me ritme të kënaqshme, gjë që shihet nga vëllimi i madh i standardeve që adoptojmë. Deri tani janë adoptuar 78% të standardeve EN, nga 80% që duhet të jenë adoptuar deri në fund të 2008. Krahas punës për adoptimin e standardeve evropiane po punohet edhe për shfuqizimin e standardeve të pastra shqiptare dhe sidomos ata që konfliktojnë me EN, por më shumë duhet bërë në këtë drejtim, mbasi bashkëpunimi i biznesit në Komitetet tona

Teknike është ende i dobët. Janë duke u përpiluar listat për shfuqizimin e standardeve konfliktuale, gjë që është e lidhur me VKM në të cilat ka referencë ndaj standardeve të pastra shqiptare.

Me përmirësimet që po i bëhen dhe do i bëhen në të ardhmen *database*-it të standardeve, do të jemi në gjendje t'i përmbushim të gjitha kërkesat që përmban ky kusht lidhur me statistikat e plota për adoptimin dhe shfuqizimin e standardeve.

Kushti 8- Proçedurat e punës janë pothuaj në përputhje të plotë me Rregulloret e brendëshme të CEN dhe CENELEC.

Programi i Punës 6 mujore të standardeve notifikohet në Qendrën e Përbashkët të Informacionit të ISO/IEC dhe të gjitha standardet e adoptuara dhe mënyra e tyre e adoptimit (me devijime apo jo) nga DPS notifikohen në CEN & CENELEC. Ky program publikohet në faqen e internetit të DPS.

Tashmë pothuajse është pezulluar puna për hartimin e standardeve të reja shqiptare. Tre vitet e fundit nuk është bërë asnjë standard i ri i pastër shqiptar, por janë bërë vetëm rishikime të dy standardeve ekzistuese, në drejtim të përmirësimit dhe përafrimit me kërkesat bashkëkohore.

Kushti 9 – Ekziston ligji kombëtar për botimet, e drejta intelektuale dhe politika komerciale. Njihet dhe zbatohet Guida 10 e CEN/CENELEC në lidhje me shpërndarjen dhe shitjen e publikimeve të CEN&CENELEC. Në konformitet me rregullat për të ruajtur të drejtën e autorit standardet botohen duke shkruar në faqen e parë logon e të drejtës së autorit.

Duke u nisur nga prioritetet e DPS, një rëndësi e madhe i është dhënë promovimit të rëndësisë e përfitimeve që ka përdorimi i standardeve europiane nga prodhuesit vendas dhe subjektet publike.

Faqja e internetit

Gjate këtij viti është përgatitur faqja e re e internetit www.dps.gov.al, e cila është pasuruar hap pas hapi me informacione të ndryshme në formën e të reja ve njoftimeve, artikujve etj.

Ngjarjet më të rëndësishme të vitit për Drejtorinë e Përgjithshme të Standardizimit janë pasqyruar në këtë faqe, duke përfshirë kontrata, takime, konferenca, paketa të reja standardesh, buletine informative, katalogun e standardeve etj. Kjo faqe është përgatitur edhe në anglisht, ku jepet informacion rreth DPS-s dhe mënyrës së organizimit të sistemit të standardizimit në Shqipëri. Gjithashtu, në këtë faqe të interesuarit mund të gjejnë edhe Katalogun e Standardeve Shqiptare të 2007 në anglisht, ku është edhe udhëzuesi përkatës i përdorimit në gjuhën angleze në linkun: http://www.dps.gov.al/dpsonline/search_eng.php?gj=Eng

Janë përgatitur dhe publikuar një sërë artikujsh në lidhje me të rejat më të fundit në fushën e standardizimit. Këto artikuj kanë pasur si qëllim informimin dhe rritjen e ndërgjegjësimit të operatorëve ekonomikë për rolin që luajnë standardet.

U realizua design-i i kartolinës së Vitit të Ri, e personalizuar për DPS-në, e cila u shpërnda elektronikisht. Kjo kartolinë e personalizuar është vendosur edhe në faqen e internetit të DPS-s

Numërohen rreth 1061 klikime në faqen e DPS, ku kohëzgjatja mesatare e çdo klikimi është 4.20 minuta.

Artikuj

Janë përgatitur dhe publikuar artikuj mbi standardin S SH EN ISO 14001:2004 – Sistemet e menaxhimit mjedisor – Specifikime, standard i cili në bashkëpunim edhe me Konsorciumin ADA (projekti INTEREG III) është i përkthyer në shqip.

Artikujt mbi standardet ISO 22000 dhe ISO 22005, si dhe standardet e tjera shumë të njohura dhe të rëndësishme për biznesin tonë si ISO 9000, ISO 9001 dhe ISO 14000.

Artikulli për Ditën Botërore të Standardeve, 14 Tetori 2007, ku lider të organizmave ndërkombëtare të standardizimit si ISO dhe IEC theksonin rolin e standardeve në jetën tonë të përditëshme dhe se si do të ishte bota pa standarde.

Një tjetër artikull përmban fjalën e z. Genc Ruli, "*Rritje e interesit të bizneseve për të përdorur standarde*" botuar në gazetën "Ekonomia" të datës 2 Dhjetor 2007, si dhe progres raporti i fundit i BE-së mbi standardizimin.

Buletinet

Në kuadrin e sigurimit të transparencës dhe gjithëpërfshirjes në aktivitetin e standardizimit një nga elementët është edhe publikimi i Buletineve periodike të DPS. Gjatë këtij viti janë publikuar 3 buletine (nr. 30, 31, 32) dhe ka mbaruar puna përgatitore për buletin e katërt. Publikimi i buletineve është bërë në letër, elektronikisht në CD dhe është vendosur edhe në faqen e internetit, duke dhënë një informacion të hollësishëm për standardet e ratifikuara, standardet e shfuqizuara dhe duke kërkuar mendimin publik për ato standarde që kanë statusin e draft-standardeve.

Publikimi i katalogut

Katalogu i Standardeve Shqiptare 2007 është një tjetër element i parimeve të standardizimit mbi sigurimin e transparencës dhe gjithëpërfshirjes, i cili këtë vit pati një paraqitje të ndryshme nga vitet e mëparshme, me qëllim përdorimin më praktik të tij. Ai u dizajnuar në një format A5 me letër shumë të lehtë dhe me CD. Katalogu është vendosur edhe në faqen e internetit të DPS <http://www.dps.gov.al/dpsonline/search.php?gj=A1> sëbashku me udhëzuesit e tij të përdorimit në shqip dhe anglisht.

Broshura

Në kuadrin e rritjes së ndërgjegjësimit mbi rolin e standardeve, u realizua përkthimi dhe botimi i 3 broshurave, përkatësisht: "*Direktivat dhe standardet që lidhen me to*", "*Standardizimi European në një kontekst global*" dhe "*Markimi i produkteve dhe çertifikimi i sistemeve*". Broshurat përmbajnë informacion të rëndësishëm për direktivat e BE-së dhe rolin e standardeve në zbatimin e tyre, konceptet e standardizimit European në mbështetje të tregtisë ndërkombëtare si dhe për markimin e produkteve dhe çertifikimin e sistemeve.

Për çdo broshurë janë realizuar *design*-e përmes të cilave është tentuar të jepet mesazh i qartë dhe lidhje midis tekstit dhe figurës. Janë realizuar kopertina për buletinet, katalogun, manualin e përdorimit të katalogut në CD, kartolina e urimit për vitin 2007, në të cilat është përdorur një llogjikë dizenjimi, e cila tenton të krijojë identitetin e produkteve të DPS-së dhe lidhjen e standardeve me jetën e përditshme.

Konferenca dhe seminare

U organizua Konferenca Ndërkombëtare "*Roli i Infrastrukturës së Cilësisë në zhvillimin ekonomik të vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe integrimi i tyre në BE*". Konferenca u përshëndet nga zoti Genc Ruli, Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, zotit Helmut Lohan, Ambasador i Delegacionit të BE-së në Tiranë, si dhe u dhanë prezantime nga personalitete në nivel European në fushën e standardizimit dhe infrastrukturës së cilësisë. Mbi 150 specialistë dhe autoritete të fushës së standardizimit, akreditimit dhe metrologjisë morën pjesë në të.

Një tjetër aktivitet ka qenë ai me rastin e Ditës Botërore të Standardeve, 14 Tetori 2007, ku morën pjesë mbi 60 persona dhe ku lektorët ishin vendas dhe të huaj.

Marrëveshjet

Gjatë këtij viti DPS ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me ASK (Agjensia e Standardizimit në Kosovë) e cila përcakton qartë mënyrën e bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve në fushën e standardizimit. Në marrëveshje ndër të tjera ASK caktohet nga DPS si Shitës Zyrtar i Standardeve Shqiptare (S SH) në fuqi. Janë lidhur dy Kontrata shitjeje për standardet me Institutin e Ndërtimit dhe Laboratorin Kibe 1 në Durrës, të cilat nuk kanë rezultuar të sukseseshme deri tani, si dhe është lidhur një marrëveshje bashkëpunimi me Agjensinë Rajonale të Zhvillimit në Korçë. Marrëveshjet janë të rëndësishme për DPS sepse tentojnë rritje të promovimit dhe rëndësisë që ka përdorimi i standardeve Europiane e ndërkombëtare, rritje të përdorimit të këtyre standardeve nga biznesi vendas dhe për rrjedhojë edhe rritje të të ardhurave të DPS nga shitja e standardeve.

Televizioni

Ne kuadrin e dhënies së informacionit rreth institucioneve të infrastrukturës së cilësisë, rreth hallkave të kësaj infrastrukture dhe rolit të saj në ekonomi, DPS ka organizuar një emision televiziv në A1 dhe ka dhënë një intervistë në televizionin ALSAT.

Trajnime të administratës

Nisur nga nevojat e specialistëve të ministrive të linjës dhe të institucioneve të tjera qëndrore për njohuri në procesin e transparencës, pjesë e detyrimeve të Republikës së Shqipërisë ndaj OBT dhe shteteve anëtare të saj, DPS organizoi disa trajnime me specialistë dhe drejtues të departamenteve që merren me hartimin e rregullave teknike në Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, në Ministrinë e Shëndetësisë, atë të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. Trajnimet u drejtuan nga specialistë të DPS-s dhe Institutit Britanik të Standardeve (BSI).

Ekspozita – Panaire


DPS mori pjesë në panairin “Expo-Prima” që u zhvillua në Tiranë në datat 18-23 Tetor 2007. Në pavionin tonë u vunë në dispozicion kopje të materialeve të përgatitura deri tani për qëllime promovimi, Katalogu i Standardeve Shqiptare në letër dhe CD e postera të ndryshëm. Në panair u përcollën të gjitha informacionet në lidhje me standardet, lehtësitë e të qënit bashkëpunëtor i DPS-s, mënyrën e përdorimit të katalogut, rëndësine dhe përfitimet nga përdorimi i standardeve, etj.

Publikimet

Janë shpërndarë gjithsej gjatë vitit 2007 rreth:

- 300 copë nga sejcila broshurë të përgatitur nga DPS;
- 220 copë Katalogë të Standardeve Shqiptare (letër);
- 170 copë Katalogë të Standardeve Shqiptare (CD);
- 500 copë fletëpalosje të DPS; dhe
- 300 copë fletëpalosje mbi Direktivat e New Approach-it.

Si rezultat i një pune intensive në drejtim të ndërgjegjësimit të operatorëve ekonomikë vendas gjatë këtij viti janë shitur gjithsej **1137** standarde (përkundrejt **523** standardeve në 2006), nga të cilat për këtë vit **789** standarde janë standarde Europiane S SH EN përkundrejt **276** standardeve S SH EN gjatë 2006.




Nga shitja e këtyre standardeve janë krijuar të ardhura në shumën prej **2.191.699*** lekë. Muaji që ka krijuar më shumë të ardhura ka qënë Dhjetori me një shumë prej **792.443** lekë të ardhura. Gjatë këtij viti blerësit kanë qënë 39 nga sektori publik dhe 52 nga ai privat.

Standardet më të shitura për vitin 2007 kanë qënë **S SH EN 17025:2006**, **S SH EN ISO 9000:2004**; **S SH EN ISO 9001:2000**; **S SH EN 590:2006**, dhe **S SH EN 228:2006**.


** Disa nga subjektet që kanë blere standardet kanë qënë bashkëpunëtorë të DPS dhe çmimi i aplikuar për to ka qënë 50% e çmimit të standardeve*

Grafiku i mëposhtëm tregon qartë vendin që zë shitja gjatë këtij viti e standardeve S SH EN krahasuar me standardet e tjera (S SH dhe S SH ISO).

Viti	S SH EN	S SH	S SH ISO
2007	789	223	125




Grafiku dhe tabela e mëposhtëme japin hollësira në lidhje me ecurinë e shitjeve për vitin 2007 (e shprehur në lekë):




Muajt Viti 2007	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII
Të ardhurat ne leke	69 650	219 506	113 658	102 152	135 495	113 990	155 645	91 921	113 348	73 471	253 053	792 443

Grafiku i mëposhtëm japin ecurinë e të ardhurave nga shitja e standardeve krahasuar në vite nga 2005 - 2007, sipas muajve:



Numri i standardeve të shitura krahasuar në vite nga 2005 – 2007 dhe raporti i standardeve EN me totalin gjatë këtyre viteve, jepet si më poshtë:




Lidhur me detyrimet që kemi si Pikë Referimi e OBT, gjatë këtij viti janë qarkulluar rregullisht të gjitha notifikimet e marra nga vendet anëtare të OBT, në të gjithë ministrinë dhe institucionet shtetërore, sipas përkatësisë. Më shumë notifikime të huaja kemi patur për Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorëve. Duhet theksuar se komunikimi me këtë ministri dhe me ministrinë e tjera të linjës përsa i përket notifikimeve dhe kërkesave për informacione të ndryshme që lidhen me fushat që ministrinë mbulojnë është përmirësuar dukshëm, gjë që tregohet edhe në vijim.

Gjatë këtij viti janë bërë 19 notifikime shqiptare (TBT) të projekt ligjeve të ardhura nga ministrinë e linjës dhe janë ndjekur me korrektësi të gjitha komentet e ardhura

nga subjekte të ndryshme në lidhje me këto notifikime dhe 40 notifikime janë kryer lidhur me projekt aktet ligjore e nënligjore apo urdhërat e Ministrit të MBUMK që kanë të bëjnë me masat sanitare e fitosanitare (SPS).

Gjithsej janë bërë 71 notifikime nga të cilat 28 janë notifikime të projekt akteve ligjore e nënligjore që kanë ndikim në mos krijimin e barrierave teknike në tregtinë ndërkombëtare (TBT) dhe 43 notifikime janë lidhur me projekt aktet ligjore e nënligjore dhe Urdhërat e Ministrit të MBUMK që kanë të bëjnë me masat sanitare e fitosanitare (SPS) në mbrojtje të shëndetit të njerëzve, bimëve, kafshëve dhe faunës nën-ujore. Grafiku i mëposhtëm jep ecurinë e notifikimeve në vite.



Gjithashtu kemi patur disa pyetje/kërkesa nga subjekte të ndryshme të huaja të cilët interesohen për të eksportuar në vendin tonë dhe me ndihmën e institucioneve përkatëse kemi realizuar dhënien e informacioneve korrekte.


Janë kryer notifikimet e programeve të punës 6 mujore të standardeve në Qendrën e Përbashkët të Informacionit të ISO/IEC dhe në CEN & CENELEC të të gjitha standardeve të adoptuara dhe mënyra e tyre e adoptimit (me devijime apo jo) nga DPS në Ka vazhduar azhurnimi i *database*-it të klientëve të DPS-s, ku evidentohen të gjitha të dhënat e blerësve të standardeve, të cilët kontaktohen për të dhënë të gjitha informacionet rreth standardeve të reja në fuqi që lidhen me fushat e tyre të aktivitetit dhe çdo ndryshim që mund të kenë pësuar ato standarde që janë blerë nga klientët. Është punuar me arkivën elektronike duke hedhur standardet e reja çdo javë dhe duke hequr gjithë standardet e shfuqizuara.

Spektori i Personel Organizimit për periudhën Janar – Dhjetor 2007, punën e ka ndërtuar mbi dispozitat ligjore e nënligjore, detyrat e përcaktuara në rregulloren e brendëshme të DPS –së si edhe në udhëzimet e herëpashershme të Ministrisë së Financave e METE.

Mbi këtë bazë është bërë planifikimi e detajimi i buxhetit të vitit 2007, duke kryer në kohë rakordimet përkatëse me Ministrinë e Financave e Degën e Thesarit, është nxjerrë bilanci kontabël vjetor i DPS-së për periudhën janar- dhjetor 2006, i cili është

dorëzuar brënda afateve të përcaktuara nga Ministria e Financave, është bërë planifikimi i prokurimeve mbështetur në regjistrin e prokurimeve publike, është bërë inventarizimi i pasurisë së DPS, si edhe janë mbajtur të gjitha evidencat kontabile sipas ligjit “Për Kontabilitetin”.

Realizimi i treguesëve të buxhetit për periudhën janar – dhjetor 2007 paraqitet si më poshtë:



Siç shihet edhe nga grafiku i mësipërm plani i shpenzimeve buxhetore për **artikullin 600** (paga, shpërblime e të tjera shp. personeli) është realizuar 10.866 mijë lekë kundrejt 12.000 mijë lekë që është plani ose në masën 91%, Duke sqaruar këtu që në punonjësit në organikë kishim një me leje lindje, pagesa e së cilës është përballuar nga Sigurimet Shoqërore, vlen të theksohet se është bërë një planifikim i drejtë dhe ndjekje korrekte në realizimin e këtij artikulli.

Artikulli 601 (kontrib. për sig. shoq. e shënd.) është realizuar 1.999 mijë lekë nga 2.000 mijë lekë që është plani.

Artikullin 602 (mallra e shërbime të tjera) është realizuar 5.611 mijë lekë nga 5.700 mijë lekë që është plani, ose në masën 98%, ç’ka tregon për një planifikim të drejtë dhe ndjekje me korrektësi të shpenzimeve. Për përdorimin e fondeve për këtë artikull, sipas analizave, është zbatuar procedura kërkesë për propozim dhe prokurimi me vlerë të vogël. Konkretisht për “blerje karburanti” është përdorur procedura kërkesë për propozim, mbështetur në ligjin “Për prokurimin publik”, ndërsa për mallrat e shërbimet e tjera është proceduar sipas udhëzimit “Për blerjet me vlerë të vogël”.

Realizimi i këtij artikulli sipas analizave paraqitet si më poshtë:


Artikull	Analize	pershkrimi	plani vjetor	realizimi	
				12 mujori vlefte	12 mujori %
602			5.700.000	5.611.494	98,4%
	602/01	kancelari		355.150	
	602/03	mat.per funks.e pj. te zyr,		447.400	
	602/1007	libra e publ. prof.	-	153.712	
	602/2001	en. elektrike		252.460	
	602/2003	shp. telefonike	-	556.072	

602/2010	sherb print e publ		478.000
602/2099	sherbime te tjera		554.350
602/31	karburant		895.860
602/32	pj kemb, goma, bateri		248.964
602/33	sig. automjeti		32.400
602/40	Shpenzime udhetimi	-	964.583
602/5	Shpenzime per miremb.	-	274.075
602/9	Shp. te tjera operative	-	398.468

Janë ndjekur dhe likujduar me korrektësi detyrimet e Institucionit tonë ndaj organizmave ndërkombëtarë si ISO; IEC; CEN; CENELEC për rrjedhojë;

Artikulli 605 (transf. korente për org. ndërk), është realizuar 4.250 mijë lekë nga 4.300 mijë lekë që është plani, ose në masën 99%.

Shpenzimet për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara, **artikulli 231**, paraqitet si më poshtë:




Siç shihet edhe nga grafiku kemi një realizim në 1.399 mijë lekë nga 2.000 mijë që është plani ose në masën 70%. Planifikimi për këtë artikull ka qënë me strukturë 1.000 mijë lekë rikonstruksion godine dhe 1.000 mijë lekë blerje paisje. Rikonstruksioni i godinës nuk u realizua pasi pati zvarritje në realizimin e procedurave për kalimin e zyrave të Albkontrollit në pronësi të DPS, por më pas duke u mbështetur në Urdhrin Nr. 151, datë 12.09.2007 të Kryeministrit “ Për rritjen e efektivitetit të përdorimit të fondeve për investime” ne nuk mund të prokuronim fonde pas datës 15.10.2007. Për këto arsye kemi bërë transferim të fondeve buxhetore brënda strukturës së investimeve nga zëri “rikonstruksion” në zërin “paisje zyre” duke bërë të mundur realizimin e fondeve si më sipër.

Për realizimin e fondeve buxhetore në të gjithë artikujt janë mbajtur në konsiderate limitet mujore të përcaktuara nga Ministria e Financave sipas llogarive dhe janë respektuar këto limite duke bërë edhe kuadraturën çdo muaj me Degën e Thesarit.

Realizimi i të ardhurave dytësore

Është punuar pozitivisht për shitjen e standardeve në subjektet brënda dhe jashtë vendit . Për rrjedhojë të ardhurat janë realizuar në shumën 2.167 mijë lekë ose 52 % më shumë se viti 2006. Raporti i të ardhurave të realizuara me fondet buxhetore të planifikuara për vitin 2007 është në masën 8 % ose 2 % më shumë se në vitin 2006, siç shihet edhe grafikisht.



Realizimi i detyrave në sektorin e personelit

Objekt i punës së sektorit të personelit, gjatë vitit 2007, ka qënë menaxhimi i drejtë i burimeve njerëzore. Duke bashkërenduar punën me Drejtorinë e Standardeve dhe të Integritimit ky sektor ka përcaktuar nevojat për trajnime e kualifikime, dhe ka gjetur rrugët për realizimin e tyre. Në tërësinë e punës është mbështetur dhe ka zbatuar VKM dhe Udhëzimet në funksion të detyrave të përcaktuara. Mbi këtë bazë u punua me kujdes për të zbatuar VKM Nr. 477, datë 13.07.2007 “ Për disa ndryshime në vendimin Nr. 726, datë 21.12.2000” si edhe VKM Nr. 478, datë 18.07.2007 “ Për miratimin e strukturës dhe të nivelit të pagave të nëpunësve të disa institucioneve në varësi të ministrave të linjës”, duke reflektuar këto ndryshime edhe në kontratat individuale të punës.

U bë vlerësimi i punës për periudhën një vjeçare të vitit 2007 për çdo punonjës, që u bë pjesë e dosjes personale të secilit.

Funksionimi i Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë në DPS për vitin 2007

Në zbatim të Politikës dhe Objektivave të cilësisë për vitin 2007 dhe plotësimin e kushteve për antarësim me të drejta të plota në CEN dhe CENELEC, detyra kryesore në lidhje me sistemin e menaxhimit të cilësisë ishte përmirësimi i vazhdueshëm i tij dhe përafrimi i dokumentacionit tonë të cilësisë me kërkesat e shprehura në Rregulloren e Brendshme të CEN/CENELEC. Ndryshimi i strukturës organizative të DPS, shtroi detyrën e shtrirjes së sistemit dhe plotësimin e tij me procese e procedura të reja. Në lidhje me këtë janë bërë rikonceptimi dhe përmirësimi i proceseve (kryesisht proceset e notifikimeve, publikimeve, arkivimit, marketingut, mirëmbajtja e faqes së internetit, etj.), ripunimi i procedurave (8 procedura të ripunuara), hartimi i procedurave të reja (6 procedura të reja) dhe përmirësimi i regjistrimeve (regjistrat e trajnimeve, regjistrat e notifikimeve, shitjes, etj). Në të gjitha procedurat e hartuara ose të ripunuara janë reflektuar kërkesat e direktives 98/34/EC “Parashtrimi i një procedure për sigurimin e informacionit në fushën e standardeve dhe rregullave teknike”, amenduar me direktivën 98/48/EC, të Rregullores së Brendshme të CEN/CENELEC, ligjit “Për Standardizimin”, si dhe të gjitha aktet nënligjore në të cilat mbështetet puna e DPS.

Për të matur shkallën e kënaqjes së palëve të interesuar me nivelin e shërbimit të ofruar, u organizua një *survey*, ku palët e interesuara shprehën mendimet e tyre për

nivelin e shërbimit të ofruar. Rezultatet e këtij *survey* shërbyen si bazë për të përmirësuar proceset tona sidomos atë të përkthimeve.

Për mirëmbajtjen e SMC janë realizuar auditime të brendshme, përditësuar lista e dokumentacionit duke reflektuar çdo ndryshim të dokumentacionit, lista e shpërndarjes së dokumentacionit si dhe ndjekja e zgjidhjes së tyre, janë ndjekur veprimet korigjuese të ndërmarra si dhe matja e efektivitetit të tyre dhe realizuar mbledhje e Rishikimit të Menaxhimit. DPS vazhdon të mbetet i vetmi institucion publik i çertifikuar sipas standardit ISO 9001:2000.